



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KRYETARI

Nr. 5174 Prot.

Shijak, më 02.12.2024

URDHËR

Nr. 474 datë 02.12.2024

**“PËR NGRITJEN E NJËSISE PËRGJEGJËSE PËR SINJALIZIMIN DHE
MBROJTJEN E SINJALIZUESVE ”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të Ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Ngritjen e njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, me përbërje si më poshtë:
 - Arjola Rama, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Auditit të Brendshëm, me cilesinë e Drejtuesit të njësisë.
 - Rei Harizi, me detyrë Specialist i Sektorit të Auditit të Brendshëm në cilesinë e Anetarit të njësisë.
2. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve do të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe do të zbatojë të gjitha procedurat që parashikon legjislacioni në fuqi.
3. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve do të mbajë në vijimësi kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
ELTON ARBANA



Adresa:Lagja"Erzen"shijak,Tel:+355712252,ëebsite:ëëë.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov.al